



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

Durrës më 27.10.2021

Lënda : Njoftim për konsultim publik të projekt-vendimit

Në mbështetje të nenit 18, të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Këshilli Bashkiak Durrës përpara shqyrtimit dhe miratimit të disa akteve zhvillon konsultime.

Me dorëzimin pranë Sekretares së Këshillit Bashkiak të Projekt-Vendimit dhe Relacionit “**PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT KUNDREJT TARIFËS, TË PALESTRAVE TË SHKOLLAVE TË ARSIMIT 9 VJEÇAR DHE TË MESËM PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE SPORTEVE PAS PROGRAMIT MËSIMOR DHE NË DITËT E PUSHIMIT**”, të propozuar nga Zëvendëskryetarja e Bashkisë Durrës, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak ka nisur procesin e Konsultimit Publik.

Në kuadër të këtij procesi, Këshilli Bashkiak publikon këtë projekt-vendim, në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës (www.durres.gov.al), sipas parashikimeve të ligjit Nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

Për këtë qëllim, mirëpresim çdo koment dhe sugjerim Tuajin, mbi këtë projekt-vendim, të cilat duhet të dërgohen në adresën e e-mail : keshillidurres@gmail.com, brenda 20 ditëve nga publikimi në faqe.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin.

SEKRETARE KËSHILLIT BASHKIAK Durrës

Dorina Milja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

PROJEKT VENDIM

NR____, DATË__/_/____/2021

PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT KUNDREJT TARIFËS, TË PALESTRAVE TË SHKOLLAVE TË ARSIMIT 9 VJEÇAR DHE TË MESËM PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE SPORTEVE PAS PROGRAMIT MËSIMOR DHE NË DITËT E PUSHIMIT

Në mbështetje të nenit 259 e në vijim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1/1.1, shkronja “b”, nenit 23, pika 11 dhe 12, nenit 25 pika 2, nenit 54 shkronja “e” dhe nenit 55 pikat 4 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; nenit 28, të ligjit nr. 69/2012 “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 79/2017, “Për sportin”, VKB nr. 89, datë 26.07.2021 “Për një ndryshim në VKB Nr.127, datë 24.12.2020 për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2021 në lidhje me dhënien në përdorim të palestrave të shkollave të arsimit 9 vjeçar dhe të mesme për zhvillimin e aktiviteteve sportive pas programit mësimor dhe në ditët e pushimit”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe Komunitete Fetare, kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe,

TË VENDOSË:

1. Miratimin e Projektit “Shkollat si Qendër Komunitare”, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Miratimin e përdorimit kundrejt tarifës të palestrave dhe hapësirave rekreative të shkollave të arsimit 9 vjeçar dhe atij të mesëm për zhvillimin e aktiviteteve sportive pas programit të rregullt mësimor dhe në ditët e pushimit.
3. Përdorimi i palestrave dhe ambjenteve të tjera rekreative sipas pikës 2 të këtij vendimi, bëhet përkundrejt pagesës së tarifës të përcaktuar në vendimin nr. 89, datë 26.07.2021 të Këshillit Bashkiak “Për një ndryshim në VKB Nr.127, datë 24.12.2020 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2021 në lidhje me dhënien në

përdorim të palestrave të shkollave të arsimit 9 vjeçar dhe të mesme për zhvillimin e aktiviteteve sportive pas programit mësimor dhe në ditët e pushimit”.

4. Miratimin e marrëveshjes trepalëshe “Tip” që nënshkruhet ndërmjet Bashkisë Durrës, Drejtorisë së Shkollës dhe personave fizikë/juridikë që do të rezultojnë fitues pas përfundimit të procesit të konkurrimit, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi dhe që është pjesë përbërëse e tij.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe Komunitete Fetare.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55 të ligjit nr.139/2015, ”Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

DREJTORIA LIGJORE

**Drejtor
Arben Isaku**

**DREJTORA E ARSIM, KULTURE, RINI,
SPORTE DHE KOMUNITETE FETARE**

**Drejtor
Adrian Gurra**

KRYETAR

Emiriana Sako

Koncept: *D. Murataj*
Pranoi: *V. Manushi*
Miratoi: *A. Isaku*